ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 te Ligjit nr. 04/L-042 per Prokurimin Publik te Republikes se Kosovës, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 281/20
Datë/Datum. 07.05.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Një ankesë kundër: Komuna e Junikut

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 636-19-5225-5-1-1

Sa i përket tenderit për Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"Arfa Group "sh.p.k., ; "Euroasphalt" sh.p.k.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Deçan

(Adresa)

Sllup, Deçan | ***14000***

(Vendi) | *(Kodi postar)*

045 505 091

(Numri Telefonit) | *(Numri i Faks-it)*

Fadil Hadergjonaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nishmarfa@hotmail.com

(Adresa elektronike)

07.05.2020

(Data e parashtrimit të ankesës) | *(Nënshkrimi dhe vula)*

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontrat I publikuar me datë 17.07.2019
-Di hapjesë së ofertave 26.08.2019 ,
-Me dt.25.04.2020 kemi parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim
-Vendimi mbi refuzimin e kërkeses për ri-shqyrtim te dt.29.04.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve. *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit te Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve. *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] ***Jo*** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Nga AK kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetit të prokurimit :" Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë" nr i Aktivitetit të prokurimit: 636-19-5225-5-1-1 të inicuar nga Komuna e Junikut,me dt 29.04.2020 me arsyetimin se nuk jemi palë me interes juridik dhe material sipas nenit 111 lidhur me nenin 4.1.26 të LPP-së

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim

AK me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe atë të neneve si më poshtë:
Nenin 1,
Nenin 4.1.26
Neni 6,
Neni 7,
Neni 59,
Nenit108A
Ninin 111 të LPP.

*** Sipas Nenit 118 te LPP, OSHP-ja do te kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund te kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që te gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rreshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë te qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet te cilat mbështesin secilën bazë te ankesës tuaj.

Në pajtim me dispozitat e nenit 109 parashtrojm këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të prokurimit me rastin e refuzimit të kërkesës sonë për ri-shqyrtim si dhe për arsyet e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit përmes njoftimit me leter standarde për tenderuesit e eliminuar për aktivitetin e prokueimit:"Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë"nr.i Aktivitetit të prokurimit: 636-19-5225-5-1-1 të inicuar nga Komuna e Junikut.

AK-Komuna e Junikut me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit e në veçanti me rastin e vlerësimit ,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderve por edhe me rastin e ri-shqyrtimit të kërkesës sonë na eliminon nga ky aktivitet i prokurimit për dy arsye të cilat nuk qëndrojnë dhe bëne :
-Shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së dhe
-vërtetim të gabuar të gjendjesë faktike.

Lidhur me kërkesën tonë për ri-shqyrtim AK ka vepruar në kundërshtim me interepretim e KRPP lidhur me diskualifikimin tonë nga procedura prokurimit sipas nenit 99.2 të LPP.Interepretimi i KRPP është i qartë dhe sqaron saktë periudhë kohore se për cilat aktivitete të prokurimit OE përjashtohet për pjesmarrje në procerduart e prokurimit.
KRPP në interpretimin e tij ka sqaruar se përjashtimi nuk mund të vlej për prokurimet që janë në proces dhe até për dy arsye:
1.sanksioni duhet të vlej vetëm për prokurimet brenda një viti nga data e vendimit,në fakt sanksioni të të kthehj para kohës kur ka ndodhur rrethana e sanksionit dhe
2.Nëse përjashtimi –sanksioni do të vlej edhe për aktiviteti i prokurimit që janë në proces,efekti i vërtet sanksionues efekti sanksionues do të ishte më shumë se një vit gjë që do të bie ndesh me ligjin.

Bazuar në interpretimin e KRPP i cili është institucioni i vetëm për interpretimin e dispozitave të LPP, ku në këtë rast ka dhe një interpretim bazuar në kompetencat dhe ayorizimet konfor nenit 87 të LPP-ës.nga interpretimi i KRPP gjejmë se nuk mund të sanksionohet OE i cili ka një aktivitet të prokurimit në implemnetim sepse nuk mun të ndërpres kontratën gjatë kohës së përjashtimit sipas nenit 99.2 të LPP dhe situata tjetër është që veprimet e OE të përjashtuar nuk mund të kthehen retroaktiv paramarrjes së vendimit për përjashtim sepse nuk kan lidhje me aktivitetet tjera,poashtu pjesmarrja në aktivitetet e prokurimit kanë ndodhur para marrjes së vendimit nga OSHP.
Përjashtimi nga aktivitetet e prokurimit sipas nenit 99.2 të LPP vlenë vetëm për prokurimet që zhvillohen pas dates së marrjes së vendimit nga ana e OSHP sepse nuk ka kuptim që të ndëriten prokurimet në implemnetim dhe ato që janë në proces e të cilat nuk ndërlidhen me shkeljen e gjetur në aktivitetin tjetër i cili është kontratë në vetë.
OSHP në vedimin e saj për përjashtim nga aktivitetet e prokurimit nuk ka sqaruar se në cilat aktivitetet e prokurimi ka efekt përjashtimi sipas nenit 99.2 të LPP-ës. se a përfshin edhe aktivitete që janë në proces apo vetëm ato që përfshin periudhën pas marrjes së vendimit për përjashtim.nga interpretimi i KRPP konfirmohet se OE nuk ka të drejt pjesëmarrje vetëm për aktivitetet që do të zhvillohen gjatë kohës se përjashtimit nga OSHP dhe jo për ato në proces apo në fazë implementuese.
Është e kuptueshme nga vetë dispozita e nenit 99.2 të LPP-së e cila qartë e sanksionon dhe e definon këtë qështje ku thuhet citat"....të diskualifikoj një operator ekonomik nga pjesëmarrja në një prokurim publik per një periudh një(1) vjeçare" pra kjo dispozit e kufizon nga pjesmarrja në prokurimet publike në një perjudh një vjeçare të cilat do të ndodhin pas marrjes së vendimit por jo për ato që OE ka marr pjesë e për të cilat ka qenë në pajtim me LPP dhe të cilat janë duke u implementuar.
Lidhur me pretendimin tonë ne kërkesën për ri-shqyrtim AK-Komuna e Junikut ka refuzuar këtë kërkesë vetëm duke u thurur në até se konform nenit 111 lidhur me nein 4.1.26 të LPP jemi palë pa interes juridik dhe material duke marr për bazë vendimin e dt.18.03.2020 me nr.PSH.110.111/20 të panelit shqyrtues të OSHP me arsyetimin se ne jemi në listën e zezë konform vendimit të OSHP me nr.1149/19.

Ky aktivitet i prokurimit ka filluar në muajin korrik të vitit 2019 ndërsa vendimi i OSHP për listë të zezë është marr pas fillimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe vendimi i lartë cekur nuk mund të ketë veprim apo efekt prapaveprues por është i zbatueshëm nga diata e

neshkrimit të saj për një periudh kohore 6 muajshe dhe për këtë periudh kohore ne nuk kemi të drejtë të marrim pjesë në aktivitetet e prokurimit deri në kalimin e kësaj mase.
Bazuar në të cekurat më lartë gjejmë se AK me rastin e ri-sherimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundershtim me dispozitat e nenit 7 të LPP Barazia në trajtim jo diskriminim citat i nenit 7.1. "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj OE në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veproj në mënyrë jo diskriminuese".
Po ashtu AK me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundershtim me nenin 62 të LPP sepse nuk janë plotësuar kushtet ligjore për anulim derisa ne jemi OE i përgjegjshëm.
AK me eliminimin tonë si OE të cilit kemi pas ofertën tonë me qmim më të ulët ka vepruar në kundershtim me nenin 1 të LPP citat i nenit 1.1 të LPPës:
" 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese,koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bejnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".
Po ashtu edhe neni 6 i LPP-së i obligon AK të sigurojnë fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike citat i nenit 6 të LPP-së:
" Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsiderate qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë ne dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

AK nuk ka bërë vlerësimin,ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 59.4 të LPP.
Paragrafi 4 i nenit 59 të këtij ligji, përcakton, citojmë:
"4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve."

AK si kriter të saj për dhënien e kontratës është përcaktuar për tenderin e përgjegjshëm me qmim më të ulët ashtu siq e parasheh neni 52 të LPP por ne praktik është e kundërta me veprimet e saja AK eliminon ofertën e përgjegjshme me qmim më të ulëtë duke e anuluar kunderligjshëm aktivitetin e prokurimit.
Arsyetimi i AK se ne nuk jemi palë me interes juridik dhe material bie ndesh me nenin 111 lidhur me nenin 4.1 26 sepse nuk ka vërtetuar në asnjë form se neve na mungon interesi juridik dhe material,ne konfirmojn se jemi ligjërisht të përgjegjshëm dhe eliminimi yne është gabim në interpretim të vendimit të OSHP nr 1149/19 dhe nenit 99.2 të LPP-së,vendimi i lartë cekur nuk e ndalon përfundimin e procedurave në zhvillim nëse ky vendim ka efekt prapavepruës OSHP ka qenë i detyruar që ta sqaroj me rastn e marrjes së këtij vendimi dhe

se për cilat aktivitete e prokurimit ka efekt një sqarim i till nuk e gjejmë në këtë vendim por vetëm përjashtohet në pjesëmarrje në procedurat e prokurimit në një kohë prej 6 muajsh. Lidhur me këtë interpretimi i KRPP-së ka sqaruar këtë qeshtje.

Provë:Interpretimi i KRPP.

Andaj bazuar në të gjeturat e cekura më lartë OSHP me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese lidhur me aktiviteti i prokurimit:"Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë"nr.i Aktivitetit të prokurimit: 636-19-5225-5-1-1 të inicuar nga Komuna e Junikut të inicuar nga AK-Komuna e Junikut të merr këtë:.

V E N D I M

1.Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "Premium Bakery lidhur me aaktivitetin e prokurimit për tenderin: Arfa Group "sh.p.k.&"Euroasphall" sh.p.k., Deçan :"Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë"nr.i Aktivitetit të prokurimit: 636-19-5225-5-1-1.

2.Anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhënie të kontratës lidhuir me aktivitetin e prokurimit: :"Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë"nr.i Aktivitetit të prokurimit: 636-19-5225-5-1-1 dhe lënda të kthehet në ***ri-vlerësim.***

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne konsiderojmë se dëmet materiale janë humbja e kontratës me të cilin pësojmë në aspektin financiar.
Shpenzimet e përgaditjesë së tenderit.
Sigurimi i tenderit.
Shpenzimet e ankesës.
Largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në prespektiv dhe imazh të kompanisë tonë
Fitimi i planifikuar për këtë tender

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës se eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.
f) Dëshminë e pagesës së tarifës se ankimit në përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë te shkruar që ka te bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim te paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*